

GLOBALIZIMI DHE BIOMA FETARE

Kryepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë
Fortlumturia e Tij Anastasi
Përkthyer nga Kostandin N. Xhuba
Globalizmi dhe Orthodhoksia, Tiranë 2004.

Afrimi, njohja dhe bashkekzistenca krijuese e njerëzve dhe e popujve të rruzullit tokësor, dikur ka qenë një vizion tërheqës. Gjatë shekullit tonë u bë synim i ndërgjegjshëm. Kohët e fundit rrezikon të zhvillohet në një makth specifik. Por, sido që të cilësohet, ky proces përshpejtohet përditë; me kontributin e shumë faktorëve dhe me rezultat përfundimtar ende të papërcaktuar.

Fjala globalizim (globalization, mondialisation) ka marrë një kuptim të veçantë dhe përmbledh zhvillimet dhe tendencat dinamike që karakterizojnë çerekun e fundit të mijëvjeçarit të dytë. Në veçanti, në fushën e ekonomisë, ky term tregon procedurën, sipas së cilës ekonomitë e vendeve të ndryshme inkuadrohen totalisht në një sistem ekonomik mbarëbotëror, me përqendrimin e prodhimit botëror, të tregtisë dhe të informacionit në disa qendra të caktuara. Ndërkombëtarizimi që pason, kontribuon në varësinë reciproke në rritje të shoqërive.

Shumë libra dhe artikuj po botohen gjatë viteve të fundit rreth kësaj teme¹. Nga diskutimi i shumanshëm që po zhvillohet, unë do të kufizohem duke nënvizuar në

¹ 1. Shih p.sh.: St. Gill and D. Law, *The Global Political Economy, Perspectives, Problems and Policies*, John Hopkins University Press, Baltimore, Md. 1988. E. Luard, *The Globalization of Politics*, Macmillan, London 1990. M. Featherstone (ed.), *Global Culture, Nationalism, Globalization and Modernity*, SAGE, London 1990. I të njëjtit, *Undoing Culture, Globalization, Postmodernity, Social Theory and Global Culture*, SAGE, London 1992. E.B. Kapstein, *Governing the Global Economy, International Finance and the State*, Harvard University Press, Cambridge, Mass. 1994. M. Shaw, *Global Society and International Relations*, Polity, Cambridge 1994. M. Waters, *Globalization*, Routledge, London 1995. D. Held, *Democracy and the Global Order. From the Modern State to Cosmopolitan Governance*, Polity, Cambridge 1995. E. Hobsbawm, *Age of Extremes. The Short Twentieth Century 1914-1991*, Abacus, London 1995; përkth. gr. nga V. Kapetanakis, *Epoka e ekstremeve. Shekulli i shkurtër i njëzetë 1914-1991*. Themelio, Athinë 1995. Ch. W. Kegley, Jr.- E.R. Wittkopf, *The Global Agenda. Issues and Perspectives*, Mc Graw Hill, New York 1995. D.C. Korten, *When Corporations Rule the World*, Earthscan, London 1995. B. Axford, *The Global System: Economics, Politics and Culture*, Polity, Cambridge 1995. K.C. Abraham, "Globalization: A Gospel and culture perspective", *International Review of Mission* 85(1996), fq. 85-92. J. Adda, *La Mondialisation de l'économie*, 2 vols., La Découverte, Paris 1996. Wl. Andreff, *Les multinationales globales*, La Découverte, Paris 1996. H. Henderson, *Building a Win-Win World, Life Beyond Economic Warfare*, Berret-Koehler Publishers, San Fransisko 1996. P. Hirst and Gr. Thompson, *Globalization in Question*, Polity, Cambridge 1996. H. Mowlana, *Global Communication in Transition. The End of Diversity?*,

vija të përgjithshme disa karakteristika, të cilat përcaktojnë kuadrin e ri ku zhvillohet bioma fetare në epokën tonë.

A VEÇANTITË DHE PASOJAT E GLOBALIZIMIT

Faktorët e globalizimit.

1. Në procesin e globalizimit kontribuan: Së pari, zhvillimi shumë i shpejtë i teknologjisë dhe, kryesisht, revolucioni elektronik, që sollën ndryshime katalitike në sektorët e prodhimit, komunikimit, edukimit dhe argëtimit. Ndryshime këto që lehtësuan interesat dhe aktivitetet ekonomike fitimprurëse, ndërkombëtare dhe pa emër, me natyrë centralizuese.

Së dyti, shembja e një bote të tërë idesh, aspiratash dhe strukturash, në vendet e socializmit real, me shkatërrimin e ekonomive të tyre dhe evidentimi i kapitalizmit si zgjidhja e vetme alternative.

Së treti, veprimet dhe vendimet e shteteve të mëdha dhe e organizmave ndërkombëtarë, që tregojnë se globalizimi nuk është tanimë një dukuri më vete, por është ideologji dhe planifikim politik i të fuqishmëve ekonomikisht.

SAGE, Thousand Oaks, Ca., London 1996. M. Patterson, Global Warning and Global Politics, Routledge, London 1996. S. Amin, Capitalism in the Age of Globalization, ZED Books Ltd., London 1997. J. Baylis, St. Smith (eds), The Globalization of Politics. An introduction to international Relations, Oxford University Press, New York 1997. M. Castells, The Information Age. Economy, Society and Culture, 3 vols., Blackwell, Oxford, Maldon 1997. U. Beck, Was ist Globalisierung? Irrtümer des Globalismus - Antworten auf Globalisierung, Suhrkamp, Frankfurt 1997. Përkth. greqisht: G. Pavlopoulos: Ç'është Globalizimi. Pikëpamje dhe përgjigje të gabuara, Ed. Kastaniotis, Athinë 1999. Clark, Globalization and Fragmentation, International Relations in the Twentieth Century, Oxford University Press, Oxford - New York 1997. St. Gill (ed.), Globalization, Democratization and Multilateralism, United Nations University Press, Tokyo 1997. A. Hoogvelt, Globalization and the Postcolonial World. The new Political Economy of Development, Macmillan, London 1997. K. Raiser, "Oikumene and Globalization", Echoes, WWC, Geneva, nr. 12/1997, fq. 3-4. Shih në të njëjtin numër artikujt e autorëve: H. Mousson - P. Taran, "Globalization and the social clause debate". L. Boff, "A new alliance between humankind and nature". J.M. Rao, Globalization: A view from the South, ILO Employment and Training Department, Employment Papers 8, Geneva 1997. M. Albrow, The Global Age. State and Society beyond Modernity, Stanford University Press, Stanford 1997. E.B. Albanis, Globalizimi, Trochalias, Athinë 1998 (bibliografia fq. 317-339). Fu-Chen Lom Yue-Man Yueng (eds), Globalization and the World of Large Cities, The United Nations University, Tokyo - New York - Paris 1998. D. Haralambis, Demokracia dhe globalizimi, Fondacioni Sakis Karagiorgas, Athinë 1998 (bibliografia: fq. 337-378). Shih dhe librat në shën. 2, 3, 6, 8.

Shpejtësia me të cilën kryhen ndryshimet në të gjitha fushat kryesore të ekonomisë, të teknologjisë dhe të informacionit, shpesh krijon marramendje dhe shqetësim. Kështu, ndërsa në fillim përpjekjet për afrim dhe koordinim mbarëbotëror ngjanin me një shi të dobishëm që do të begatonte tërë rruzullin tokësor, tani ato kryhen në trajtë stuhish dhe përmytjesh, që kërcënojnë çdo cep të tokës me përrrenj të vrullshëm.

Rol bazë, me ndikime të shumëllojshme, pozitive apo negative, gjatë procesit të globalizimit, luajnë: Së pari, disa qindra shoqëri shumëkombëshe, të cilat vënë nën pushtetin e tyre prodhimin botëror, lëvizjen e mallrave dhe informacionin. Së dyti, bashkëpunimet ndërmjet shteteve (si p. sh. NAFTA, ASEAN). Së treti, organizatat joqeveritare në nivel global dhe, së katërti, rolin koordinues synojnë ta luajnë institucionet financiare botërore, si Fondi Monetar Ndërkombëtar (International Monetary Fund, IMF) dhe Banka Botërore (World Bank).

Pikëpamjet e përgjithshme lidhur me progresin dhe zhvillimin krijohen veçanërisht në qytetet e mëdha, sipas modeleve perëndimore. Mjetet e ndryshme të informimit dhe, kryesisht, televizioni satelitor, i furnizojnë në mënyrë të pandërprerë njerëzit në mbarë botën me modele jetese të prodhuara në qendra të caktuara, që u shërbejnë objektivave të leverdishme.

Disa studiues mbrojnë asnjësinë dhe aspektet pozitive të dukurisë, si p.sh. amerikani Paul R. Krugmann në veprën e tij “Internacionalizmi Popullor”². Ndërsa të tjerë, si francezi Emm. Todd, e kontestojnë në vetvete këtë fakt: “Çështja e një ‘globalizimi’, e një parimi abstrakt që vepron ‘nga jashtë’ mbi të gjitha kombet, nuk ka bazë. Nuk është veçse një mit, inskenim i ndjenjës së pamundësisë së ‘elitës’ politike dhe kulturore”³.

Ndryshimet rrënjësore.

2. Fakt është se ky proces që quhet globalizim sjell ndryshime rrënjësore në jetën e njerëzve; si ndryshime pozitive, të cilat më lehtë konsiderohen si të vetëkuptueshme, ashtu dhe negative.

Ndër të parat veçohen:

- a) Përparimi dhe zhvillimi i vrullshëm i teknologjisë dhe i të gjitha shkencave.
- b) Lëvizja tepër e shpejtë e të mirave materiale dhe e arritjeve të reja.

² P.R. Krugmann, *Pop Internationalism*, 1996. Karakteristik është titulli i përkthimit të librit në frëngjisht: *Globalizimi nuk është fajtor (La mondialisation n'est pas coupable - Vertus et limite du libre échange)*, La Découverte, Paris 1998.

³ E. Todd, *L'illusion économique. Essai sur la stagnation des sociétés développées*, Paris 1998, fq. 297.

c) Lehtësimi i komunikimit ndërmjet njerëzve në të gjitha vendet e botës me zhdukjen e largësive - rrjete të zhvilluara të telefonisë, internet, televizion satelitor, komunikacion.

d) Lufta kundër shumë sëmundjeve në shkallë botërore.

e) Kufizimi i analfabetizmit.

f) Njohja e pozitës, e rëndësisë dhe e rolit të gruas dhe të rinisë.

g) Zgjerimi i horizonteve të mendimit që, të paktën teorikisht, sanksionon lirinë dhe të drejtat themelore të njeriut.

h) Nxitja dhe forcimi i parimeve dhe i strukturave demokratike.

i) Format e ndryshme të solidaritetit midis popujve, të cilat lehtësojnë pjesëmarrjen e sa më shumë njerëzve në botën që formohet.

Përgjithësisht, globalizimi ka ndihmuar për një zhvillim mahnitës të njerëzimit, ndërsa u ofron individëve dhe popujve gjithnjë e më shumë mundësi për të njohur dhe për të shfrytëzuar shanse që për brezat e mëparshëm ishin të pakapshme dhe të paimagjinueshme.

Por, paralelisht, lëvizin, madje me shpejtësi më të madhe, pasojat negative të globalizimit:

a) Hendeku ndërmjet vendeve të botës po thellohet. Vendet e pasura bëhen më të pasura dhe ato të varfra bëhen më të varfra, duke u përkulur nën peshën e borxheve të jashtme tepër të mëdha. Por, dhe në çdo vend shfaqen çarje të reja ndërmjet të kamurve dhe të skamurve. “Në vendet e zhvilluara nga shkëmbimet e lira përfitojnë vetëm 20% e popullsisë”⁴.

b) Në të gjitha shtetet po formohet një pakicë e vogël, e shëndoshë ekonomikisht, me mundësi të mëdha influence, e cila merret kryesisht me realizimin e interesave të saj. Një rreth tjetër individësh dhe grupesh, përpiqen të përshtasin ritmin e jetës së tyre me atë të bërthamës së privilegjuar të shoqërisë.

c) Njëkohësisht, miliona njerëz mënjanohej nga shoqëria dhe përfundojnë në kushte jetese nën kufirin e varfërisë. Krahas kësaj, shkatërrohen mundësitë e shoqërive vendase për t’u mbështetur në format e tyre shpirtërore dhe shoqërore.

d) Zhvendosje të reja të mëdha të fuqisë punëtore vihen re dhe dallgë të reja emigrantësh e refugjatësh ekonomikë dynden drejt vendeve të pasura. Papunësia është bërë kërcënuese dhe në shumë vende zhvillohen rrezikshëm ksenofobia dhe racizmi.

⁴ E. Todd, vepr. kujt. Ndërsa banorët e Veriut zënë rreth 20% të popullsisë së planetit, ata kontrollojnë mbi 80% të të ardhurave botërore. Por, njëkohësisht, në Bashkimin Evropian ka mbi 50 milionë të varfër. Ign. Romonet, Geopolitics of Chaos, përkth. angl. A. Lyn Secara, Algora, New York 1998, fq. 6.

e) Modelet e zhvillimit të vazhdueshëm dhe të konsumit të të mirave materiale, me shfrytëzimin e pamenduar dhe të pamëshirshëm të burimeve natyrore çojnë drejt katastrofave ekologjike në të gjithë planetin.

f) Krimi dhe korrupsioni zhvillohen me mënyra të pakontrollueshme në nivel planetar, me modernizimin e plotë teknologjik. Një pjesë e madhe, veçanërisht e rinisë, nën trysinë e kësaj vorbulle, kërkon rrugëdalje tek dhuna, vetëbraktisja dhe narkotikët. Me gjithë deklaratat e shumta për vlerën e njeriut, sundon përbuzja e jetës njerëzore.

Humnerë hipokrizie i ndan deklaratat e përgjithshme dhe parimet teorike të organizmave botërore nga zbatimi i tyre në gjatësi dhe gjerësi të ndryshme të rruzullit tokësor. Siç thotë bukur Kr. Janaras, kemi “shenjtërimin e ‘tregut të lirë’ dhe kambialeve të tij rregulluese, variantin e dobishëm të të drejtave individuale (që meqë është i dobishëm, por i fetarizuar, u përshtatet lehtë qëllimeve farisaikë ‘të shenjta’ çnjerëzore)”⁵.

g) Në nivelin politik, shumë nga institucionet demokratike po minohen dhe dobësohet fuqia, autoriteti dhe efektiviteti i tyre. Qendrat nacionale të pushtetit nuk e kontrollojnë plotësisht politikën ekonomike. Ato janë të detyruara që t’u përshtaten urdhrave të qendrave të tjera, ndërkombëtare, rrymave më të gjera të përbotshme. Pas triumfit të ekonomisë së tregut, dy janë mundësitë që paraqiten. Siç thekson Gérard J. Lafay: “Nga njëra anë, procesi i globalizimit, që nxitet nga ndërmarrjet dhe lehtësohet nga ulja e kostos së transportit dhe komunikacioneve. Nga ana tjetër, ruajtja e kombeve që janë të ngjitura pas trojeve të tyre dhe që kërkojnë të organizohen në kuadër vendor...”⁶.

Veç këtyre, me mbarimin e Luftës së Ftohtë nuk erdhi paqja në tokë. Janë ndezur pothuaj 50 luftëra të tjera dhe janë duke u zhvilluar rreth 40 të tilla. Kështu, është krijuar, sipas formulimit të Butros Butros Galit, “një kategori e re shtetesh, që nuk janë as të zhvilluara, as në zhvillim, dhe nuk ndodhen as në fazën e tranzicionit, por bëjnë pjesë në një kategori të katërt: bëjnë luftë ose me njëri-tjetrin, ose luftë civile, ose ndodhen ende në një periudhë tranzicioni pas një lufte që zgjati për vite të tëra”. Dhe ish-Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së përfundon: “Problemet e vërteta që do të mundojnë planetin janë probleme që nuk mund të zgjidhen veçse në nivel planetar”⁷. Probleme të tilla janë, ndërmjet të tjerave, e drejta e deteve, ndryshimet klimatike, burimet ujore, armët e reja kimike dhe biologjike, lëvizjet e miliona emigrantëve në nivel botëror.

⁵ Kr. Janaras, Kultura: problemi qendror i politikës, (gr.) Indiktos, Athinë 1997, fq. 27

⁶ G.J. Lafay, Comprendre la Mondialisation, Economica, Paris (2)1997, fq. 7-8.

⁷ D. Dhombres: “Problemet e mëdha do të zgjidhen vetëm në nivel planetar”, Le Monde dhe To Vima, 10.5.98.

Eshtë e dukshme se globalizimi lidhet me imponimin e një kulture, krijuesit e së cilës pretendojnë se është më e mira. Perceptimi, kriteret dhe mënyra e funksionimit të tërë sistemit janë mbështetur tek kapitalizmi perëndimor, në logjikën e një ekonomie të lirë, dinamika e së cilës mbështetet në nxjerrjen e vazhdueshme të fitimeve. Globalizimi nuk është vetëm një proces ekonomik. Është imponim, i drejtpërdrejtë apo i tërthortë, i një sistemi mendimi që injoron apo dhe shkatërron veçoritë e popujve dhe njerëzve të veçantë, dhe mënjanon ose prish vlerat, siç janë miqësia, ndershmëria dhe vetëpërmbytja, duke paraqitur një model konsumi me synime për fitime të vazhdueshme, nën ndikimin e të cilit shpesh shkatërrohen marrëdhëniet njerëzore.

Në librin e tij të fundit, i cili qarkulloi para disa muajsh (Globalizimi), Philippe Moreau Defarges, konkludon: “Globalizimi me sa duket po i hap njerëzimit dy rrugë të skajshme. U jep njerëzve ndjesinë se janë të mbyllur në një burg, që është toka... Ose gjeneron ndërgegjen e unitetit të njerëzimit... Globalizimi nuk sjell fundin as për njeriun, as për historinë e tij. Nuk është veçse nënprodukt i progresit teknik. Sigurisht, nuk është rastësi që globalizimi realizohet në çastin kur njeriu zhytet në dy pafundësi: në vogëlsinë e pafund të materies dhe në madhësinë e pafund të yjeve”⁸.

B

DUKURIA FETARE NË FUND TË SHEKULLIT XX

Drejtimi për tek Pafundësia mbetet karakteristikë e përvojës fetare. Bioma fetare dhe, më gjerë, feja që e shpreh atë në kohë dhe në hapësirë, nuk është një mbifenomen i etikës, i logjikës, i jetës shpirtërore dhe i shoqërisë, por përbën një fenomen më vete me një kategori protogjene referimi; është diçka krejt e veçantë: e Hirshme, e Shenjtë. Feja zë fill me frikën përpara së Shenjtës dhe arrin kulmin me takimin personal, në marrëdhënien përjetuese të njeriut me të Shenjtën, ku marrin pjesë intelekti, ndjenja, vullneti, koshienca dhe subkoshienca. Brenda njeriut ekziston dëshira, vrulli drejt Pafundësisë. Bëhet fjalë për një “shtrirje” të pandërprerë ekzistenciale tej kufijve shqisorë, tek e përtejshmja, e përjetshmja. Në këtë fushë lëviz përvoja fetare; tashmë paraqitet si shprehje primitive fetare, siç është pneumatolepsia [sundimi i shpirtave]; kalon në lartësimet shpirtërore mistike, për të arritur kulmin në kapërcimin ekzistencial, në metamorfozën

⁸ Ph. Moreau, La mondialisation, Presses Universitaires de France, Paris 1997, fq. 124-125.

ontologjike “nga lavdia në lavdi” (II Korint. 3:18), në shoqërinë e dashurisë me Perëndinë⁹.

Mbarëbotërore është perspektiva e feve të mëdha.

1. Vizioni i një shoqërie mbarëbotërore ka qenë gjithnjë karakteristikë e feve të mëdha¹⁰. Dhe këtë globalizim shpirtëror, kulturor, ato u përpoqën ta arrinin me përhapjen e besimit të tyre në rrethe gjeografike gjithnjë e më të mëdha; fillimisht Budizmi, më pas Krishterimi dhe me vonë Islami. Nga ky veprim rezultuan edhe sferat e njohura të influencës së feve të ndryshme. Shkollat e shumëllojshme të Induizmit, duke theksuar relativitetin dhe pluralizmin e të vërtetave fetare, nuk vepruan me zell për të arritur evidentimin e tyre jashtë. Fetë që lulëzuan në Kinë, duke ndjekur rrugën e tyre, adoptuan në kohët e vjetra propozimet e Konfucit në përputhje me thëniet kontradiktore të propozuara nga Lao-Tse, ndërsa përvetësuan dhe zhvilluan ide të rëndësishme të Mahajana Budizmit¹¹. Në epokën e sotme, populli kinez - le të mos harrohet - përbën një të pestën e popullsisë së Tokës, përqafoi teorinë marksiste, të cilën e përpunoi Mao Ce Duni dhe e ripërshtasin mjeshtërisht pasardhësit e tij.

Dallimi bazë i vizionit fetar nga globalizimi modern është se fetë synojnë universalizimin, duke propozuar të vërtetat e tyre dogmatike dhe parimet e sjelljes. Dhe të gjitha fetë, në një mënyrë apo në një tjetër, kanë theksuar nevojën e simpatisë, butësisë, njeridashjes, thjeshtësisë dhe drejtësisë. Në hapësirën e feve monoteiste, qendra konstante e referimit dhe e përballimit të njeriut, si dhe të problemeve shoqërore, ka qenë besimi tek Perëndia i gjallë, Krijuesi dhe mbrojtësi i gjithësisë.

Por, krahas kontributit të tyre në afrimin e njerëzve dhe të popujve, fetë shpesh kanë qenë faktorë konfliktesh të tmerrshme dhe ndarjesh të papajtueshme, që ngritën në planetin tonë perde të ndryshme prej çeliku, krijuan grupe kulturash të mbyllura hermetikisht dhe ndaluan rrugën drejt bashkëjetesës harmonike

⁹ A. Yannoulatos, “Feja”, Enciklopedia Arsimore Greke, vol. 21, Fetë, Ekdotiki, Athinë 1992, fq. 172-175.

¹⁰ Artikuj të mirëqenë për çështjet e fesë shih: M. Eliade (ed.), The Encyclopaedia of Religion, 16 volume, Macmillan, New York 1987. Ndërmjet më të rinjve: N. Smart, The World’s Religions. Old Traditions and Modern Transformations, Cambridge University Press, Melburne 1989, repr. 1997. M. Malherbe, Les religions de l’humanité, Criterion, 2nd ed., Paris 1992. J. Bower (ed.), The Oxford Dictionary of World Religions, Oxford University Press, Oxford, New York 1997.

¹¹ Shih në mënyrë përmbledhëse A. Yannoulatos: “Budizmi”, “Induizmi”, “Islami” në Enciklopedinë Arsimore Greke, vol. 21, Fetë, Ekdotiki, Athinë 1992. Gjithashtu: “Konfuci” dhe “Lao Tse” në Enciklopedia Arsimore Greke, vol. 5, Ekdotiki, Athinë 1982, fq. 9-10, 177.

mbarëbotërore. Nuk janë të pakta rastet kur fetë, në kombinim me politika të ndryshme, kanë përkrahur arrogancën dhe agresivitetin e shumë popujve.

Qëndresa e shumëllojshmërisë fetare.

2. a) Në disa periudha historike dhe në disa qendra të veçanta fetare, është kultivuar pikëpamja se shoqëria mbarëbotërore do të realizohej me imponimin e një feje konkrete. Dhe në këtë drejtim, u mobilizua jo vetëm fjala dhe puna filantropike, por, me të njëjtin entuziazëm, dhuna dhe lufta. Natyrisht, gjithnjë me mendimin ose me preteksin se është fjala për ...të mirën e të tjerëve.

Sot, asnjë studiues i fenomenit të fesë nuk përkrah një mundësi të tillë. Pluralizmi fetar është një fakt i padiskutueshëm. Një nga statistikat e fundit (1991), për numrin e përgjithshëm të popullsisë së planetit prej 5.480.010.000 njerëzish, jep këto shifra¹²: të Krishterë: 33,4% (1.833.022.000). Myslimanë: 17,7% (971.328.700). Pa fe: 16% (876.232.000). Induistë: 13,4% (732.812.000). Budistë: 5,7% (314.939.000). Ateistë: 4,4% (240.310.000). Pasues të traditave fetare kineze: 3,4% (187.107.000). Ithtarë të feve të reja: 2,6% (143.415.000). Ithtarë të besimeve tradicionale racore: 1,8% (96.531.000). Dhe vijojnë, në përqindje më pak se 0,3% për çdo komunitet

¹² I.S. Markham (ed.). A World Religius Reader, Blackwell, Oxford 1996, repr. 1997, fq. 356-7. Shifrat llogariten në bazë të të dhënave që japin: United Nations, World Population Prospects 1990, U.N. (ed.), New York 1991, dhe D.B. Barret, World Christian Encyclopaedia. A comparative study of churches and religions in the modern world, AD 1900-2000, Oxford University Press, Nairobi 1982, sipas dinamikës së vitit 1991, si dhe të dhënave më të reja. Statistikat fetarologjike për shumë arsye duhen marrë parasysh vetëm në mënyrë indikative. P. sh. në numrin e të krishterëve llogariten të gjithë të pagëzuarit, në numrin e myslimanëve të gjithë banorët e një vendi. Numri i agnosticistëve ose i ateistëve llogariten në varësi të banorëve të shteteve (si Kina), ku sundon ideologji ateiste. Sipas një përlllogaritjeje tjetër, fetë kryesore në botë gjatë vitit 1995, kishin pothuaj këtë kapacitet: 1.470 milionë të krishterë, 910 milionë myslimanë, 720 milionë induistë, 330 milionë budistë, 220 milionë animistë (pasues të besime racore), 1.200 milionë agnosticistë dhe ateistë. V. Odon, Les Religions dans le Monde, Flammarion, Dominos, Paris 1995, fq. 14. D.C. Barret, në veprën e tij voluminoze që përmendëm (fq. 6), duke përpunuar të dhënat statistikore me kujdes dhe me përlllogaritje të detajuara, parashikonte se në vitin 2000 pas Kr., në numrin e përgjithshëm të popullsisë së Tokës prej 6.259.642.000, do të ishin:

Të Krishterët	2.019.921.366	32,3%
Myslimanët	1.200.653.040	19,2%
Pa fe	1.071.888.370	17,1%
Induistët	859.252.260	13,7%
Budistët	359.092.100	5,7%
Ateistët	262.447.550	4,2%
Pasuesit e traditave fetare kineze	158.470.664	2,5%
Pasuesit e feve të reja	138.263.800	2,2%
Pasuesit e besimeve racore	100.535.850	1,6%

fetar, sikët, hebrenjtë, shamanistët, konfucianët tradicionalë, bahai, xhainistët dhe shindoistët.

Me emigrimin e popullatave në vende të tjera dhe, kryesisht, në qytete të reja të mëdha, pothuajse në të gjitha kontinentet, prania e shumë komuniteteve fetare është e njëkohshme në të njëjtin rajon dhe shoqëri. Nëpër botë të krishterët janë vendosur në të 270 vendet e planetit, jofetarët në 236 vende, bahai në 220, myslimanët në 184, ateistët në 139, hebrenjtë në 134, ithtarët e besimeve racore në 104. Besimet e tjera ndodhen në më pak se 10 vende secili. Këto statistika, edhe pse mund të jenë relative, vërtetojnë pa dyshim pluralizmin e sotëm të besimeve fetare.

b) Në një periudhë të këtij shekulli është kultivuar aspirata - sidomos me mbizotërimin e ideologjisë komuniste - se konvergjenca dhe njëtrajtshmëria fetare në tokë do të arrihej përfundimisht me zhdukjen dinamike ose me mohimin e plotë të fesë. Një shembull i skajshëm i këtij planifikimi ka qenë Shqipëria, ku me forcë u imponua uniformiteti ateist. Një aspiratë e ngjashme nga ana e kundërt u kultivua në vende të tjera, që ishin ndikuar nga ana kulturore nga kapitalizmi, me përhapjen e pikëpamjes se thjesht feja do të bëhet e pavlefshme. Njeriut do t'i nevojitet gjithnjë e më pak, përderisa zgjidhjet e problemeve të veta do t'i gjejë tek shkenca dhe teknologjia. Kështu u përkrah mendimi se feja do të vdesë nga dekadencia ose nga asfiksia. Por, parashikimi se afrimi i njerëzve do të vinte me fundin e fesë, nuk doli i vërtetë.

c) Nuk ka mbaruar ende shekulli i njëzetë dhe ngjarjet kanë treguar se sa të cekëta dhe të thjeshtësuara ishin këto koncepte. Shekulli i 19-të u mbyll me shpalljen e Niçes se “Perëndia vdiq, ...dhe e vramë ne!”. Por shekulli i 20-të dhe bashkë me të edhe mijëvjeçari i dytë - mbaron me një rigjallërim mahnitës të fesë. Mbi 70,2% e popullsisë së Tokës ka adoptuar një besim fetar dhe më shumë se gjysma e njerëzimit të sotëm vazhdon, me njëerën ose tjetrën mënyrë, të besojë tek Perëndia. Kjo dinamikë e re ka ndërmarrë një rol të rëndësishëm edhe në fushën e politikës (lëvizja Khomeini në Iran, luftëtarët myslimanë në Algjeri, organizimi i myslimanëve në Turqi, “partitë e zeza” në Izrael, lëvizjet e induistëve në Sri Lanka, rritja e rrymave protestante ekstremiste në Botën e Tretë).

Pas rënies së ideologjisë komuniste, në shumë vende po zhvillohet një tip i veçantë i Islamit, i cili u ofron mbrojtje, bashkim, strehim dhe dinjitet të varfërve, shpresë për afirmim dhe drejtësi shoqërore të braktisurve¹³. Kështu po formohet një proletariati i ri, i cili armatohet me vendosmëri, qëndresë dhe militantizëm fetar.

¹³ D. Hiro, *Islamic Fundamentalism*, Paladin, London 1988. J.L. Esposito, J.O. Voll, *Islam and Democracy*, Oxford University Press, New York, Oxford 1996. Z. Anwar, *Islamic Revivalism in Malaysia*, Pelanduk Publ., Kuala Lumpur 1987. R. Wright, *In the Name of God: The Khomeini Decade*, Simon and Schuster, New York 1989. Fr. Burgat, *The Islamic Movement in North Africa*, përkth. W. Dowel, University of Texas, Austin 1993. J.O. Voll, *Islam: Continuity and Change in the Modern World*,

Por, njëkohësisht po zhvillohet një shakullimë shumë e fuqishme idesh të reja fetare dhe grupesh me përbërje të ndryshme. Kështu, shfaqet një “agresion i relatives” për të zëvendësuar absoluten fetare. Pranohet pluralizmi në kundërshtim me rregullat absolute dhe të vërtetat absolute, të cilat cilësohen si dogmatizma dhe autoritarizma. Përparësi u jepet përvojës, vështrimit dhe jo njohurisë, dogmës apo institucionit. Duke pasur si protagonist kryesor mendimin indian, propozohet ideja e “absoluteve alternative”. Përfundimisht, paraqitet një çrregullim i shumë besimeve fetare, si dhe krijimi i një nebuloze grupesh, ku gërshetohen misticizmat e shumëllojshme me urtitë dhe praktikatat e ndryshme të vjetra lindore¹⁴. Shoqëritë e varfra të Botës së Tretë, si dhe ato ish-komuniste, janë më se të prekshme nga këto ndikime, por pa u përjashtuar edhe Evropa dhe Amerika e Veriut nga këto acarime.

Rëndësia e fenomenit fetar në formimin e kulturës së shekullit të ardhshëm, është tashmë e dukshme. Madje para pak vitesh, një pedagog i shquar amerikan i studimeve strategjike, Samuel O. Huntington, me veprën e tij “Përplasja e kulturave”¹⁵, ka parashikuar një përplasje të kulturës perëndimore, siç është formuar nga romano-katolicizmi dhe protestantizmi, me kulturën lindore, në të cilën përveç Islamit ai përfshin edhe Krishterimin Orthodhoks. Sigurisht, një studiues i feve ka objeksione serioze për sa i përket trajtimit të fenomenit fetar nga ana e studiuesit në fjalë, dhe një historian për sa i përket përdorimit të rezultateve të shkencës historike dhe seriozitetit të shumë pretendimeve të autorit¹⁶.

bot. II, Syracuse University Press, Syracuse, N.Y. 1994. Për marrëdhëniet Islam kapitalizëm shih: veprën klasike të M. Robinson, Islam et capitalisme, Seuil, Paris 1976. Përkth. gr. D. Kourtovik, Islami dhe kapitalizmi, Kalvos, Athinë 1980.

¹⁴ St. Bruce, Religion in the Modern World. From cathedrals to cults, Oxford University Press, Oxford - New York 1996. F. FernandezArmesto, “Religion”, J. Grimmin, F. Fernandez-Armesto, F. Heisbourg etj. (eds.), The future now. Predicting the 21 century, Weidenfeld & Nicolson, London 1988, fq. 35-38.

¹⁵ S.P. Huntington, The Clash of Civilisations. Remaking of World Order, Touchstone, New York 1996.

¹⁶ Këto parashikime më sjellin ndër mend disa parashikime të vjetra të një historiani të rëndësishëm amerikan, K.S. Latourette, i cili në veprën e tij me vlerë për misionet e krishtera parashikonte se në gjysmën e dytë të shekullit të njëzetë, ecuria e Islamit do të ishte në zbritje (the course appears to be downwards). A History of the Expansion of Christianity, vol. VII, New York, London 1945, 493. Por ajo që ndodhi ishte pikërisht e kundërta. Islami gjatë gjysmës së dytë të shekullit tonë shënoi suksese të jashtëzakonshme në Afrikë dhe Indonezi, kontribuoi në formimin e shtetit të Pakistanit dhe, përgjithësisht, sot ai paraqet një vitalitet të veçantë. Shih: W. Cantwell Smith, Islam in Modern History, Princeton, N. Jersey 1957, (4)1996. N. Ahmad T. Grin, J.-C. Froelich, L’ Afrique islamique (Islamisches Afrika, Africa Islamica) - Le monde religieux, 29e volume de la nouvelle série, Lezay (Deux-Sèvres) 1966. B. Lewis, Islam and the West, Oxford University Press, Oxford 1993. Për një bibliografi të hollësishme mbi lëvizjet islamike rinovuese nëpër botë, shih: Y.Y. Haddad, J.L. Esposito, J.O. Voll, The Contemporary Islamic Revival: A Critical Survey and Bibliography, Greenwood Publ., Westport, Conn., 1991. Gjithashtu, shih dhe shën. 13.

Pas parashikimeve për përplasje kulturash me sa duket vjen arroganca e gjoja kulturës më të mirë dhe preokupimi se si do të mbrohet ajo. Gjithashtu, përcjellja e mesazhit indirekt: “Jemi të kërcënuar. Duhet të përgatitemi për t’u mbrojtur”. Analiza bëhet në bazë të skemave a priori; p.sh. afrim i botës orthodhokse me Islamin, duke injoruar bazën theologjike dhe dallimet historike e kulturore midis dy feve.

Por bioma fetare ka dinamikën e vet dhe nuk iu bindet kufizimeve skematike të strategjisë së të mëdhenjve. Në kërkimet dhe zhvillimin fetar ka gjithmonë diçka pa peshë që vjen jashtë hapësirës së parashikimeve njerëzore. Për ndërjegjen fetare të miliarda njerëzve, përtej zhvillimeve të njerëzimit, ndodhet një tjetër fuqi, përkujdesje dhe dashuri, ajo e Perëndisë.

Por, sado të mos jetë dakord radikalisht dikush me shumë pika të analizës historike të Huntingtonit, studimi i tij tregon se parametri i fesë ruan një rëndësi të jashtëzakonshme dhe do të ketë rëndësi edhe më të madhe në vitet që do të vijnë.

Ripërshtatja e marrëdhënive midis feve

3. Gjatë procesit të globalizimit ripërshtaten edhe marrëdhëniet midis feve:

a) Që nga fundi i shek. të 19-të, grupe intelektualësh me bindje të ndryshme fetare, janë përpjekur të flasin për formimin e një feje të re, të përbashkët, duke kërkuar emëruesat e përbashkët. Madje, pas Luftës së Dytë Botërore u zhvillua tendenca e bashkëpunimit të feve për çështje konkrete, si p.sh. për paqen (World Conference on Religion and Peace). Por, bërthama kompakte konservatore e shumicës së komuniteteve fetare, doli kundër. Kështu që këto përpjekje mbeten një tendencë e disa intelektualëve, që shpesh shpëputen nga jeta organike e komunitetit konkret fetar dhe si rezultat ata u mënjanuan dhe zëri i tyre u bë indiferent për shumicën e njerëzve. Megjithatë, kërkimet për një “fe mbarëbotërore” po vazhdojnë¹⁷.

b) Shumë shpresa për afrim dhanë fillimisht përpjekjet e ndryshme për dialog ndërmjet përfaqësuesve të dy ose me shumë komuniteteve fetare. Por, pas njohjes më të ngushtë, vjen zhgënjimi nga kontradiktat dhe divergjencat e konstatuara. Megjithatë, rruga për komunikim dhe dialog mbetet e rëndësishme, dhe nuk është veçse ajo e mirëkuptimit reciprok¹⁸.

¹⁷ Nga F. Heiler, Die Religionen der Menschheit in Vergangenheit und Gegenwart, Ph. Reclam Jun., Stuttgart 1962, fq. 877-889: “Versuche einer Synthese der Religionen und einer neuen Menschheitsreligion”, deri tek: N. Smart, vepr. kujt. (1989), fq. 549-561: Some final reflections on Global religion.

¹⁸ Përmbledhje për “Dialogët” e të krishterëve me fe të tjera, shih: S. W. Ariarajah, “Dialogue, Interfaith” in N. Lossens, J.M. Bonino, J.S. Pobe, T.F. Stransky. G. Wainwright, P. Webb (eds.),

c) Një tendencë e tretë thekson detyrën e respektimit të lirisë dhe veçantisë së tjetrit, pranimin e shumëformësisë dhe bashkekzistencën e ndërgjegjshme paqësore. Në vend të izolimit dhe të kultivimit të armiqësisë, rekomandohet sa më shumë bashkëpunim për çështje të aprovimit dhe interesit të përbashkët, siç është drejtësia shoqërore dhe rregullimi paqësor i divergjencave në nivel lokal dhe universal. Çdo komunitet fetar gjatë shekujve ka zhvilluar parimet, frymëzimet dhe praktikën e veta, që mund të rezultojnë të çmuara për arritjen e bashkëjetesës harmonike të njerëzve.

Tek dukuria e posaçme e globalizimit, me tendencën e imponimit të një kulture nga një qendër konkrete e pushtetit, komunitetet fetare parashikohet se do të jenë qendra rezistence. Fetë ofrohen si kështjella identiteti për shumë popuj për ruajtjen e fizionomisë së tyre. Pritet që ato të zhvillohen në ishuj sigurie, ku njerëzit gjejnë strehë për t'iu shmangur të këqijave që sjell globalizimi. Përfundimisht, kërkimi i realitetit suprem, i së vërtetës, i kapërcimit të vdekjes, mbetet një dëshirë e thellë dhe e drejtë e çdo njeriu.

Gjithashtu, globalizimi pritet që të kontribuojë në rritjen dhe zhvillimin e farërave dhe tendencave të gabuara në gjirin e shumë feve. Besimet fetare të veçanta janë grupe organike në zhvillim, që bëhen pre e ndikimeve, asimilojnë dhe adoptojnë ide të reja. Ato nuk lëvizin në boshllëk abstrakt; por ripërshtaten. Gjatë shekullit të fundit, ku iu dha emfazë çështjeve të paqes, të drejtësisë, të barazisë së popujve, lirisë, të drejtave të njeriut dhe të dashurisë, shumë shkrimtarë që bëjnë pjesë në fe të ndryshme, jo thjesht i kanë adoptuar por, edhe janë përpjekur për t'i paraqitur secili si pjesë përbërëse të fesë së tyre. Nuk ka rëndësi për temën tonë saktësia historike e këtyre pretendimeve, por fakti i ekzistencës së dëshirës për afrim. Ndërgjegjja fetare gatuhet, ripërshtatet, rinovohet sipas të dhënave të reja, ndikohet si nga ide të reja ashtu dhe nga të vjetra gjatë ecjes drejt globalizimit, por e ka mundësinë edhe për të ndikuar mbi formën e saj përfundimtare.

Dictionary of the Ecumenical Movement, WCC, Geneva 1991, fq. 281-287. Midis teksteve të shumta për këtë çështje shih: S.I. David, Christianity and the Encounter with other Religions. A select Bibliography. Bangalore 1988 (with an emphasis on the Indian contact). R.B. Sheard, Inter-religious Dialogue in the Catholic Church since Vatican II: An Historical and Theological Study, Edwin Mallen, Queen Town, Canada 1987. Guidelines on Dialogue with People of Living Faiths and Ideologies, WCC, Geneva 1979. S.J. Samartha (ed.), Living Faiths and the Ecumenical Movement, WCC, Geneva 1971. I të njëjtit, Courage for Dialogue. Ecumenical issues in Inter-Religious Relationships, WCC, Geneva 1981. Mitropoliti i Zvicrës, Damaskinos Papandreu, "Dialogët ndërjetarë të Kishës Orthodhokse", M. Konstantinou - A. Stiernermann (ed.), Dialogu midis Krishterimit dhe Islamit si një detyrë e përbashkët" (gr.), Paratiritis, Selanik 1998, fq. 31-51

C PËRGJEGJËSIA DHE KONTRIBUTI ORTHODHOKS

Dinamika e biomës fetare.

1. Kontributi i biomës fetare të shëndoshë në ndërhyrjet korrigjuese që duhen kryer për shërimin e pasojave të shumta negative të globalizimit, është përcaktues dhe i pazëvendësueshëm. Sepse besimi fetar ndikon në thellësinë e ndërgjegjes dhe vullnetit njerëzor, formon mendimin, moralin dhe karakterin e njerëzve. Mbarë botën mund ta çojnë drejt peripecive tragjike individët egocentristë që zakonisht krijojnë grupe të ndryshme arrogante. Këtë virus vdekjeprurës të egoizmit, vetëm bioma fetare e vërtetë është në gjendje ta neutralizojë. Ndaj, që të përballohen pasojat negative të globalizimit, në të gjitha nivelet e vendimmarrjes duhen personalitete që do të frymëzohen nga gjykimi i saktë dhe i drejtë, ndërgjegjja e pastër, nga dëshira për një botë paqësore duke respektuar lirinë dhe veçantitë e çdo personi njerëzor dhe çdo populli. Sa më autentike dhe e pastër të jetë bioma fetare, aq më me vendosmëri ndihmon me një kontribut pozitiv në skenën botërore, me zgjimin dhe frymën militante të grupeve dhe popujve të organizuar.

Ekumenizmi, hapësira shpirtërore e Orthodhoksisë

2. Të krishterët, madje në orthodhoksët, nuk ndjejmë hutim dhe as nuk befasonemi nga procesi i globalizimit. Ekumenizmi ka qenë hapësira jonë shpirtërore e vetëkuptueshme. Dimensionin e globalizimit është pjesë përbërëse bazë e Orthodhoksisë. Që në kapitullin e parë të Shkrimit të Shenjtë (Gjen. 1:1), theksohet se qielli, dheu, gjinia njerëzore, të gjitha, u krijuan nga Perëndia; ndërsa kapitujt e fundit të tij (Apok. Jn. 21-22) i kushtohen vizionit të qiellit të ri dhe tokës së re (Apok. 21:1). Me Trupëzimin e Saj, Fjala e Perëndisë mori tërë natyrën njerëzore dhe i fton në Mbretërinë e Tij që të gjithë, pa përjashtim, pa dallim race, gjuhe, prejardhjeje. Së fundi, universaliteti i Ungjillit të Jisu Krishtit kapërcen madje edhe sferën e mbarënjërëzores, shtrihet në mbarë krijesën, në të cilën njeriu merr pjesë organikisht.

Doktrina e krishterë u dëgjua për herë të parë në një vend dhe kohë konkrete, por që në fillim kishte dhe ende ruan vendosmërisht karakterin e saj mbarëbotëror dhe eskatologjik. Në Letrat e Apostullit Pavlit theksohet veçanërisht globalizmi në raport me misterin e Kishës. Ky vizion universal arrin kulmin, kur Pavli i referohet vullnetit të Perëndisë, "misterit të vullnetit të tij", që pritet të realizohet "sipas

planit kur të plotësohen kohët, që të përmbliidhen të gjitha më Krishtin, edhe ato që janë në qiejt, dhe ato mbi dhé" (Efes. 1:9-10).

Për të shkruar mesazhin e krishterë, gjatë fazës së parë të përhapjes së tij nëpër botë, u përdor gjuha greke dhe kultura greke, një nga karakteristikat bazë të së cilës ka qenë karakteri ekumenik¹⁹. Ky ka përshkuar sidomos filozofinë, shkencën, artin dhe gjuhën greke, që lehtësonte komunikimin e shumëllojshëm ndërmjet njerëzve dhe popujve. Ndërgjegjja ekumenike u kultivua me një forcë të re nga Hierarkët e mëdhenj dhe Mësuesit Ekumenikë të shekullit të katërt, të cilët realizuan kompozimin e mendimit ekumenik të lashtë grek dhe të besimit të krishterë. Edhe më vonë, në takimin e saj me popujt e Evropës Juglindore, "perandoria bizantine sakrifikon ekumenizmin e gjuhës greke për të ruajtur globalizmin e kulturës së saj"²⁰.

E tërë jeta orthodhokse adhuroese lëviz në këtë vizion mbarëbotëror. Bërthamën e saj e përbën Lutja drejtuar Zotit: "ardhtë mbretëria jote, u bëftë dëshira jote si në qiell ashtu dhe mbi dhé". Jo thjesht "për mua" ose "për ne", por "kudo mbi dhé"²¹. Besimtari, para se t'u referohet problemeve imediate të "bukës së përditshme", ftohet për të lëvizur në një horizont mbarëbotëror. Personalja dhe konkretja nuk e pengojnë atë për të menduar të përgjithshmen. Në çdo Liturgji Hyjnore, e cila është përmbledhje e misterit të shpëtimit, lutjet fillojnë "për paqen në mbarë botën" dhe arrijnë kulmin me blatin e Dhuratave të Nderuara, që bëhet "nga të gjitha dhe për të gjitha", "për gjithë botën".

Të gjitha të krenmet e mëdha orthodhokse na hapin në shpirt horizonte globalizmi. Tejet intensive është kjo atmosferë gjatë periudhës së Pashkës dhe të Pentikostisë. Përgjithësisht, vizioni mbarëbotëror mbetet perspektiva dinamike e doktrinës dhe adhurimit orthodhoks²².

Përballimi i drejtë i fenomenit të globalizimit nga ana orthodhokse, nuk është çështje ekskluzive e klerit apo e disa theologëve laikë. Ai kërkon preokupimin dhe qëndrimin e përgjegjshëm të të gjithë pjesëtarëve laikë të Kishës, me studim serioz, analizë dhe propozime lidhur me të dhënat shkencore, politike, kulturore dhe ekonomike. Do të duhet një meditim i vazhdueshëm krijues në të gjitha fushat e shkencave humanitare, politike dhe ekonomike.

¹⁹ V. Kyrkos, "Ekumenizmi i kulturës greke dhe takimi i saj me Krishterimin", Historia e Kombit Grek, vol. 6(1976), fq. 392-395.

²⁰ D. Zakythinos, "Byzance et les peuples de l'Europe du Sud-Est. La synthèse byzantine", Actes du Premier Congrès international des études balkaniques et sud-est européennes, vol. III, Histoire. Association Internationale d'Etudes du Sud-Est Européen, Sofia 1969, 22.

²¹ Joan Gojarti, Kujtesë për Shën Mattheun, Ungjillorin, Fjalimi 19.5, PG 57, 280: "Sepse nuk tha: U bëftë dëshira jote për mua ose për ne, por kudo mbi dhé".

²² Anastasios of Albania, "The Global Vision of Proclaiming the Gospel", The Greek Orthodox Theological Review 43(1998).

Ç'kërkohet nga Orthodhoksia.

3. Kisha Orthodhokse, sigurisht, nuk duhet të ndjekë taktikën e Kishës Romano-katolike, të nxitojë të prononcohet për çdo problem që del, duke përcaktuar zgjidhje të detajuara. Kjo është punë e kërkimeve të studiuesve specialistë në shkencat politike dhe shoqërore.

Ajo që kërkohet para së gjithash nga Kisha mbetet rilindja shpirtërore e njeriut, shpëtimi më Krishtin, dhënia kuptim jetës. Kështu ajo ofron më të rëndësishmen: kultivon ndërgjegjen, formon personalitete, që me konsekuencën e jetës së tyre forcojnë sistemin imunitar të shoqërisë dhe e gjallërojnë atë. Gjëja më e nevojshme për epokën e sotme janë njerëzit që disponojnë karakter, vizion, durim dhe dashuri të sinqertë, që mbështesin qëndresën ndaj egocentrizmit - individual, kombëtar apo racor. Arroganca, mania për pushtet dhe hipokrizia nuk janë vetëm karakteristika të shteteve të fuqishme dhe të mëdha, por ato depërtojnë dhe rrojnë në shpirtrat tanë.

Kisha nuk mund të bëjë pjesë në klubin e të fuqishmëve dhe të pasurve. Fuqia e Orthodhoksisë nuk është pajtuar dhe nuk është mbështetur në ushtrimin e pushtetit të kësaj bote. Teksti i famshëm i Dostojevskit për Inkuizitorin e Madh²³, përcakton qartë ngasjen e madhe të pushtetit të kësaj bote që ka përballuar Perëndimi, por që nuk ka qenë e panjohur edhe në Lindje.

Prania e Kishës duhet të jetë vazhdimisht profetike dhe kritike ndaj dukurive të ndryshme të pandjeshmërisë kundrejt mjerimit: me të ushtruarit flijues të shërbesës së saj; me ftesën për pendesë të vazhdueshme dhe konsekuente, me pjesëmarrje të përhershme në përpjekjet për drejtësi dhe paqe; me jetë të thjeshtë, në të ushtruarit dhe vetëpërmbytje. Lumurimet, siç i ka formuluar Krishti në fjalën e Tij mbi Mal, përcaktojnë moralin autentik të saj. Qëllimi i jetës së krishterë orthodhokse mbetet marrja e Shpirtit të Shenjtë. Dhe ky qëllim ndikon drejtpërdrejt në marrëdhëniet njerëzore, në nivel lokal dhe global. Sepse "fryte të Shpirtit" nuk janë disa fluturime në hapësirat jashtë botës, por "dashuri, gëzim, paqe, mirësi, besim, butësi, vetëpërmbytje" (Gal. 5:22), pra, kapërcimi i agresivitetit njerëzor dhe i konflikteve sociale, harmonizimi i marrëdhënieve midis njerëzve dhe popujve.

Kisha, me ndjenjën ekumenike që kultivon, jo vetëm kontribuon në afrimin e njerëzve, por dhe shpall, në mënyrë simbolike dhe liturgjike, shoqërinë mbarëbotërore të dashurisë. E parashijon atë si aspiratë eskatologjike. Si vizion dhe

²³ F. Dostojevski, Vëllezërit Karamazov, përkth. gr. nga A. Aleksandru, bot. Govosti, Athinë pa vit botimi, fq. 99-121, si dhe botimi shqip.

festë. Kush dëshiron, le të marrë pjesë. Ajo nuk e imponon me metoda dhune. E shpall me jetën e besimtarëve të saj. Mbretëria e Perëndisë "erdhi dhe po vjen". Është fjala për një "ngjarje" e përjetuar në jetën e shenjtorëve, të njohur dhe të panjohur, që ngushëllon në mënyrë profetike për mundësitë e njerëzimit.

Ajo që e diferencon Kishën nga çdo sistem fetar është marrëdhënia thelbësore me Perëndinë e gjallë, të cilën e ofron me fuqinë dhe hirin e komunitetit Eukaristik. "Sepse Perëndia është ai që vepron ndër ju dhe të doni e të veproni sipas pëlqimit të Tij" (Filip. 2:13). Bota nuk ndodhet në duart tona, por në duart e Tij. Me realizëm ne vazhdojmë rrugën e Kryqit të jetës sonë, duke synuar Ngjalljen. "Qiej të rinj dhe tokë të re, pas zotimit të atij (sipas premtimit të Perëndisë) presim, aty ku banon drejtësia" (II Petrit 3:13). Fjalët e fundit 'aty ku banon drejtësia' përcaktojnë ndryshimin thelbësor dallues të vizionit të krishterë mbarëbotëror nga çdo formë tjetër globalizimi.

Kush beson thelbësisht tek Krishti, që ka marrë dhe ka përtëritur tërë natyrën njerëzore, kush merr pjesë me vetëdije në Adhurimin hyjnor, kthehet në të përditshmen për të zbatuar detyrën ndaj lokales, duke synuar mbarëbotëroren.

Sinopsis.

Globalizimi është tashmë një proces në evolucion dhe nuk ka fuqi, me sa duket, që të mund ta ndalojë atë. Ai i hap njerëzimit mundësi të shkëlqyera dhe perspektiva të papritura. Por, gjithashtu mbart turbullira dhe rivendosje të njëpasnjëshme. Ndërkaq, pavarësisht nga pasojat, pozitive apo negative, kryhet pa u penguar nga psherëtimat e mundshme ose yshtjet e joekonomistëve.

Nga shumë anë dëgjohej protesta se globalizimi lëviz në drejtime që nuk garantojnë vlerat njerëzore bazë, drejtësinë, respektimin e identitetit të njerëzve, shumëllojshmërinë e kulturave njerëzore. Se rendi i ri botëror, që drejtohet nga shoqëritë shumëkombëshe, është instrument presioni për forma të reja kolonializmi. Besimtari nuk befsohet nga kjo dukuri. Globalizmi dhe ekumenizmi përbëjnë një element bazë të besimit dhe të aspiratave të tij. Ai është i bindur se bioma e vërtetë fetare ka forcë për të kontribuar vendosmërisht me ndërhyrje krijuese, duke u mbështetur në parimet e përjetshme të respektit të çdo personi njerëzor, të lirisë, paqes, drejtësisë dhe solidaritetit. T'i japë kuptim jetës së njeriut dhe tejkalimin e ankthit të vdekjes.

Ekumenizmin, orthodhoksët e kanë në gjak, i cili pastrohet vazhdimisht me gjakun e Krishtit, Shpëtimtarit të botës. Në vend të një globalizimi, që i shndërron popujt dhe njerëzit në pelte, të vlefshëm për qëllimet ekonomike të një oligarkie anonime, bioma dhe vizioni orthodhoks propozon dhe na fton në një përpjekje për shoqërinë e dashurisë. E krishterë autentike është: Të besosh atje ku gjithçka duket

e pashpresë. Sepse mbështetet në sigurinë se përfundimisht dikush Tjetër rregullon evolucionin e gjithësisë, "ai që është, që ka qenë dhe që do të vijë, i Gjithëpushtetshmi" (Apok. 1:8). Të rrosh me sigurinë se shoqëria mbarëbotërore e dashurisë e personave të lirë është një ideal, për të cilin ia vlen të luftosh. Të veprosh në mënyrë krijuese tek lokalja me perspektivë mbarëbotërore; t'i përgjigjesh me përgjegjësi detyrës konkrete, duke pasur si orientim dhe qëllim jete Pafundësinë - Perëndinë e Dashurisë.